

## Përmbledhje

- **Në TM1 2025, ekonomia e Eurozonës shënoi rritje prej 0.6 përqind, duke reflektuar përmirësim krahasuar me tremujorin paraprak, ndërsa inflacioni qëndroi në nivelin prej 2.3 përqind, në linjë me objektivin afatmesëm të BQE-së.** Vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan rritje mesatare prej 2.7 përqind, mbështetur nga konsumi privat dhe investimet publike, ndërsa shkalla mesatare e inflacionit ishte 3.3 përqind.
- **Ekonomia e Kosovës në TM1 2025 shënoi rritje më të ngadalësuar prej 3.6 përqind, krahasuar me 5.6 përqind në TM1 2024, kryesisht si rezultat i rritjes më të ngadalshme të konsumit, rënies së eksportit të mallrave dhe rritjes së importit.** Në anën tjetër, pozicioni i investimeve dhe eksporti i shërbimeve, veçanërisht shërbimeve të udhëtimit, kanë mbështetur aktivitetin ekonomik në periudhën përkatëse. Për vitin 2025, projeksionet e BQK-së parashikojnë një rritje reale të BPV-së prej 4.1 përqind.
- **Inflacioni në TM1 2025 u përshpejtua në 2.0 përqind, nga 0.7 përqind në tremujorin paraprak.** Rritja e çmimeve të ushqimit ishte nxitësi kryesor i dinamikave në shkallën e inflacionit, megjithëse u evidentuan presione inflacioniste edhe në komponentët tjerë. Inflacioni bazë ra në 1.0 përqind, megjithatë shfaqti presione inflacioniste në rritje përgjatë tremujorit. Indeksi i çmimeve të importit regjistroi rënie vjetore, ndërsa indeksi i çmimeve të prodhimit dhe i kostos së ndërtimit shënuan rritje. Parashikimet e BQK-së sugjerojnë një normë inflacioni rreth 3.3 përqind në vitin 2025, me ecuri të cenuar kryesisht nga rreziqet e jashtme si tensionet gjeopolitike dhe tregtare dhe kushtet klimatike.
- **Të hyrat primare buxhetore në TM1 2025 arritën vlerën prej 709.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 2.3 përqind. Shpenzimet buxhetore u rritën për 18.3 përqind, duke arritur në 677.4 milionë euro, ndërkohë që u krijua një suficit primar buxhetor prej 46.0 milionë euro.** Të hyrat tatimore arritën në 641.7 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 2.4 përqind, me rritje të veçantë nga tatimet direkte dhe indirekte, përfshirë TVSH-në dhe detyrimet doganore. Shpenzimet rrjedhëse u rritën me 19.4 përqind, ndërsa ato kapitale me 11.7 përqind. Raporti i borxhit publik ndaj BPV-së ra në 15.3 përqind, ndërkohë që borxhi publik arriti në 1.7 miliardë euro, me një rritje prej 3.1 përqind, duke reflektuar një rritje të borxhit të jashtëm.
- **Në TM1 2025, deficitin i llogarisë rrjedhëse u zgjerua me 9.5 përqind, duke arritur në 347.6 milionë euro, kryesisht për shkak të rënies në bilancin tregtar.** Megjithatë, sektori i shërbimeve, të ardhurat parësore dhe dytësore patën ndikim pozitiv, duke siguruar burim të qëndrueshëm të të hyrave financiare. Remitencat në këtë tremujor arritën në 291.3 milionë euro, me rritje të ngadalësuar prej 3.6 përqind. Ndërsa, investimet e huaja direkte shënuan rënie prej 8.1 përqind, duke arritur vlerën prej 197.6 milionë euro, ndonëse u shënuan rritje të investimeve në sektorin e patundshmërisë.
- **Sektori bankar** ka shënuar rritje vjetore të përshpejtuar të aseteve në TM1 2025, duke arritur vlerën prej 8.63 miliardë euro. Aktiviteti kreditues vazhdoi rritjen e lartë, si në segmentin e ekonomive familjare ashtu edhe në atë të korporatave jo-financiare. Në veçanti, rritje të lartë shënuan kreditë e reja hipotekare si dhe kreditë e ndërmarrjeve për qëllime investive. Depozitat u karakterizuan me rritje vjetore të përshpejtuar, megjithëse me ritëm më të ulët në krahasim me kreditimin, çka ka rezultuar me rritje tutje të raportit kredi/depozitë. Niveli i kredive jo-performuese ka shënuar rënie, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së portfolios kreditorë. Fitimi neto i sektorit ka shënuar rënie nga një vit më parë, rezultat ky i rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt rritjes më të ngadalësuar të të hyrave. Pozicioni i kapitalit u përforcua lehtësisht nga viti paraprak, ndërsa treguesit e likuiditetit dhe financimit shënuan trend rënës, por mbeten lartë mbi nivelet minimale rregullatore.
- **Sektori pensional** u karakterizua nga rreziqe të rritura në tregjet financiare, të cilat u reflektuan në një kthim negativ nga investimet. Megjithatë, vlera e aseteve vijoi të rritet, ndonëse me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Kontributet u rritën në mënyrë të moderuar, duke mbështetur vazhdimësinë e akumulimit të fondeve. Investimet e sektorit u orientuan më shumë drejt tregut të brendshëm, i cili shënoi ritme më të larta të rritjes krahasuar me tregun e jashtëm. Pavarësisht pasigurive në mjedisin investues, çmimi i njësisë së aksioneve të të dy fondeve shënoi rritje të lehtë.
- **Sektori i sigurimeve** shënoi ngadalësim të ritmit vjetor të rritjes së aseteve, i ndikuar kryesisht nga ngadalësimi i theksuar i ritmit të rritjes së të hyrave nga primet e shkruara në sigurimet jo-jetë. Megjithatë, sektori shënoi rritje vjetore të fitimit neto, e mbështetur nga rritja më e shpejtë e të hyrave në raport me zgjerimin më të ngadalshëm të shpenzimeve. Treguesit e qëndrueshmërisë së sektorit, përkatësisht treguesit e kapitalizimit dhe likuiditetit, shënuan rritje vjetore në nivel të përgjithshëm.
- **Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo bankar** vazhdoi rritjen e lartë dyshifrore të aseteve, megjithëse me ritëm më të ulët krahasuar me vitin paraprak, duke reflektuar trendin e ngadalësimit të rritjes së burimeve të financimit nga jashtë. Sidoqoftë, kreditimi – si aktiviteti dominues – përshpejtoi lehtësisht ritmin e rritjes, ndërsa lizingjet shënuan ngadalësim pas rritjes së theksuar në vitin e kaluar. Profiti neto i sektorit shënoi rritje, megjithatë, kthimi mesatar në asete dhe në kapital shënuan rënie të lehtë. Raporti i kredive joperformuese mbeti i pandryshuar krahasuar me periudhën e njëjte të një viti më parë.

## Lista e shkurtesave

|       |                                                                       |
|-------|-----------------------------------------------------------------------|
| ASK   | Agjencia e Statistikave të Kosovës                                    |
| BPV   | Bruto Produkti Vendor                                                 |
| BQE   | Banka Qendrore Evropiane                                              |
| BQK   | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës                                |
| EUR   | Valuta Euro                                                           |
| FAO   | Food and Agriculture Organization (Organizata për Ushqim dhe Bujqësi) |
| FMN   | Fondi Monetar Ndërkombëtar                                            |
| IÇIMP | Indeksi i Çmimit të Importit                                          |
| IÇK   | Indeksi i Çmimeve të Konsumit                                         |
| IHD   | Investimet e Huaja Direkte                                            |
| KJF   | Korporatat jo-financiare                                              |
| MFPT  | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës  |
| MMBTU | Metric Million British Thermal Unit                                   |
| WEO   | World Economic Outlook                                                |

Përmbajtja

|                                                                         |    |
|-------------------------------------------------------------------------|----|
| Përmbledhje .....                                                       | i  |
| 1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor .....                               | 3  |
| 2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare .....                | 4  |
| 3. Ekonomia e Kosovës .....                                             | 6  |
| 3.1. Rritja Ekonomike .....                                             | 6  |
| 3.2. Çmimet .....                                                       | 7  |
| 3.3. Sektori Fiskal .....                                               | 9  |
| 3.4. Sektori i jashtëm .....                                            | 10 |
| 4. Sistemi financiar .....                                              | 14 |
| 4.1. Sektori bankar .....                                               | 14 |
| 4.2. Sektori pensional .....                                            | 23 |
| 4.3. Sektori i sigurimeve .....                                         | 25 |
| 4.4. Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar .....               | 27 |
| 4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës ..... | 30 |

## 1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

**Në TM1 2025, ekonomia e Eurozonës shënoi rritje prej 0.6 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, duke shënuar përmirësim të lehtë në raport me rritjen prej 0.3 përqind në TM4 2024.** Në terma vjetor, rritja ekonomike arriti në 1.5 përqind, duke sinjalizuar stabilizim të ekonomisë së brendshme, edhe pse mbetet e ekspozuar ndaj presioneve dhe pasigurive të jashtme. Rritja u mbështet nga konsumi privat, i cili kontribuoi me 0.1 pikë përqindje, falë përmirësimit të kushteve të financimit pas uljes së vazhdueshme të normave të interesit nga BQE-ja. Konsumi publik pati kontribut neutral, ndërsa formimi bruto i kapitalit kontribuoi me 0.4 pikë përqindje. Eksporti neto kontribuoi pozitivisht me 0.3 pikë përqindje, falë përshpejtimit të eksporteve para implementimit të tarifave tregtare nga SHBA-të ndaj disa produkteve evropiane. **Për vitin 2025, BQE-ja parashikon rritje prej 0.9 përqind,** mbështetur nga pritjet për rritje të konsumit privat, si rezultat i rritjes së të ardhurave reale të ekonomive familjare dhe lehtësimit të kushteve të financimit. Megjithatë, perspektiva mbetet e brishtë për shkak të rreziqeve nga tensionet gjeopolitike dhe përkeqësimi i marrëdhënieve tregtare me SHBA-të, që mund të ketë implikime direkte në eksport dhe investime.

**Në TM1 2025, inflacioni në Eurozonë ishte 2.3 përqind, duke reflektuar një normalizim të mëtejshëm drejtë objektivit të BQE-së.** Rritja e çmimeve u mbështet kryesisht nga shërbimet, që mbeti burimi kryesor i presioneve inflacioniste, të nxitura nga rritja e pagave. Gjithashtu, çmimet e ushqimeve, alkoolit dhe duhanit, veçanërisht ato të ushqimeve të papërpunuara, kontribuuan në rritjen e normës vjetore të inflacionit. Në anën tjetër, çmimet e energjisë shënuan rënie vjetore prej 1.0 përqind në muajin mars, e që kishte ndikim zbutës mbi inflacionin e përgjithshëm. Kjo dinamikë tregon një stabilizim të ngadaltë të inflacionit, i cili gjithsesi mbetet i ndjeshëm ndaj presioneve të brendshme (si rritja e pagave) dhe rreziqeve të jashtme (si ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit dhe tensionet gjeopolitike). **Sipas parashkimeve të qershori 2025, BQE-ja pret ngadalësim të mëtejshëm të inflacionit në 2.0 përqind për vitin 2025 dhe 1.6 përqind për vitin 2026.** Në qershor 2025, BQE-ja ndërmori uljen e tetë radhazi të normave bazë të interesit, duke ulur normën e interesit të depozitave në 2.00 përqind, atë të rifinancimit në 2.15 përqind dhe normën e huadhënies në 2.40 përqind.

**Në vendet e Ballkanit Perëndimor, rritja ekonomike në TM1 2025 vlerësohet të ketë qenë mesatarisht prej 2.7 përqind e nxitur kryesisht nga konsumi privat, investimet publike dhe përmirësimi i kushteve të tregut të punës.** Kjo ecuri pozitive vjen përkundër një sërë sfidash strukturore dhe rreziqesh të jashtme që vazhdojnë të rëndojnë perspektivën e rajonit. Rreziqet kryesore përfshijnë ngadalësimin e kërkesës së jashtme, si pasojë e dobësimit të aktivitetit ekonomik në Eurozonë, pasigurinë politike të brendshme në disa vende të rajonit, si dhe përkeqësimin e kushteve globale të financimit. Faktorë tjerë sfidues janë ndikimi i ndryshimeve klimatike, vonesat në zbatimin e reformave strukturore, si dhe emigrimi i vazhdueshëm i fuqisë punëtore. **Sipas FMN-së, vendet e Ballkanit Perëndimor regjistruan rritje mesatare ekonomike prej 3.4 përqind në vitin 2024 dhe pritet të rriten me normë të ngjashme edhe në vitin 2025.** Tensionet gjeopolitike dhe ekspozimi ndaj luhatjeve në ekonominë e Eurozonës e bëjnë rajonin të ndjeshëm ndaj goditjeve të jashtme, ndërkohë që normat e interesit mbeten ende të moderuara dhe kërkesa për eksporte vazhdon të jetë e dobësuar. **Shkalla mesatare e inflacionit në TM1 2025 ishte 3.3 përqind, me shkallën më të lartë të shënuar në Serbi prej 4.5 përqind, ndërsa Kosova rezultoi të ketë shënuar normën më të ulët të inflacionit prej 2.0 përqind.**


**Në TM1 2025, kursi i këmbimit valutor të euros** kundrejt valutave të partnerëve tregtar shfaqti zhvillime të ndryshme. Euro u vlerësua në krahasim me lirën turke kundrejt tremujorit paraprak, ndërsa u zhvlerësua kundrejt lekut shqiptar, dollarit amerikan, sterlinës britanike dhe frangut zviceran. Ndërsa mbeti pothuajse e njëjtë ndaj denarit maqedonas.

## 2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

**Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare shënuan një rritje të lehtë në TM1 2025.** Indeksi i çmimeve të mallrave bazë, sipas Bankës Botërore u rrit mesatarisht për 0.9 përqind krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit të kaluar dhe 2.2 përqind krahasuar me tremujorin paraprak. Banka Botërore parashikon rënie të çmimeve përgjatë pjesës së mbetur të vitit, për shkak të ngadalësimit të kërkesës globale dhe rritjes së ofertës, sidomos në tregjet e energjisë. Megjithatë, rreziqet për rritje të çmimeve mbeten të pranishme, të nxitura nga përshkallëzimi i tensioneve tregtare, gjeopolitike, dhe kushtet klimatike.

**Çmimi i naftës së papërpunuar Brent mesatarisht ishte \$75.6 për fuçi në TM1 2025, duke reflektuar një rënie prej 9.0 përqind kundrejt periudhës korresponduese të vitit paraprak dhe rritje prej 1.4 përqind krahasuar me tremujorin paraprak (grafik 1).** Kjo rritje lidhet me sanksionet e ashpra të SHBA-ve ndaj eksporteve të naftës nga Rusia dhe Irani në janar 2025, si dhe një vale të ftohti në Amerikën Veriore që shkaktoi shqetësime rreth furnizimit me energji. Sidoqoftë, përgjatë tremujorit të parë 2025 u evidentua rënie e lehtë e çmimit, si rrjedhojë e përkeqësimit të perspektivës ekonomike globale dhe pritjeve për heqjen e kufizimeve të prodhimit nga OPEC+. Ecuria e çmimeve të naftës vijon të mbetet e cenuar nga rreziqet potenciale si përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike, veçanërisht në Lindjen e Mesme dhe tensionet tregtare. Megjithatë, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik global pritet të ushtrojë presione dominuese në kahun rënës.

**Grafik 1. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare**




Burimi: Banka Botërore.

**Çmimet e gazit natyror në Evropë u rritën në \$14.4/mmbtu, duke shënuar rritje tremujore prej 6.2 përqind dhe një rritje vjetore prej 64.6 përqind (grafik 1).** Dinamika e çmimeve u udhëhoq kryesisht nga kërkesa sezonale për ngrohje që kontribuoi në uljen më të shpejtë të rezervave si dhe nga rritja e kërkesës për LNG nga vendet aziatike. Banka Botërore parashikon rritje të çmimit gjatë vitit 2025 për shkak të kufizimeve të ofertës globale të LNG-së dhe rritjes së kërkesës. Rreziqet që mund të qojnë në rritje më të lartë të çmimeve sesa parashikohet, përfshijnë presionin për rritje të rezervave, rritjen e konkurrencës për LNG, si dhe kushtet klimatike. Ndërsa, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik, veçmas i atij industrial në Azi, mund të zbusë presionet inflacioniste në çmimet e gazit natyror.

**Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve vijoi të ndjekë ecuri rritëse duke rezultuar me rritje vjetore prej 7.9 përqind në TM1 2025 (grafik 2).** Rritja kundrejt tremujorit paraprak ishte 1.1 përqind, e nxitur kryesisht nga shtrenjtimi i aluminit, bakrit dhe kallajit, si rezultat i shqetësimeve për furnizim pas paralajmërimeve të SHBA-ve për vendosjen e tarifave ndaj importit të këtyre metaleve. Në anën tjetër, presionet inflacioniste u neutralizuan paksa nga rënia e çmimeve të plumbit, nikelit, dhe zinkut për shkak të zbehjes së kërkesës nga industria automobilistike dhe tranzicioni energjetik, oferta e lartë e nikelit, dhe ngadalësimi i

**Grafik 2. Indeksi i metaleve dhe mineraleve dhe metaleve të çmuara**



Burimi: Banka Botërore.


aktivitetit të ndërtimit në Kinë që rezultoi në rënie të çmimit të zinkut. Çmimet e metaleve bazë parashikohet të bien në vitin 2025 si rezultat i përmirësimit të ofertës kundrejt kërkesës së dobësuar.

**Indeksi i çmimeve të metaleve të çmuara shënoi rritje vjetore prej 37.6 përqind (grafik 2).** Ndërsa, në terma tremujorë u rrit për 6.5 përqind, i diktuar kryesisht nga çmimet në rritje të arit dhe argjendit. Çmimet e arit dhe argjendit kanë regjistruar nivele të larta historikisht në baza mujore, me çmimet e arit që u rritën për 7.5 përqind dhe çmimet e argjendit për 1.6 përqind në TM1 2025 kundrejt tremujorit paraprak. Rritja e çmimeve vijoi të nxitet kryesisht nga pasiguritë e larta gjeopolitike dhe përkeqësimi i perspektivës ekonomike, duke i kthyer këto metale në asete të sigurta investimi. Rrjedhimisht, ecuria e çmimeve të metaleve të çmuara pritet të vazhdojë të përcaktohet nga po këta faktorë.

**Sipas FAOs, indeksi i çmimeve të ushqimit në TM1 2025 rezultoi për 7.0 përqind më i lartë kundrejt TM1 2024, ndërsa 0.9 përqind më i ulët kundrejt tremujorit paraprak (grafik 3).**

Kushtet klimatike dhe dinamikat ofertë-kërkesë vazhdojnë të ndikojnë ndjeshëm në lëvizjet e çmimeve të ushqimit në tregjet ndërkombëtare. Kundrejt TM1 2024, rritje e dukshme u evidentua në çmimet e vajrave prej 25.9 përqind, bulmetit 21.0 përqind, dhe mishit prej 4.6 përqind. Krahasuar me tremujorin paraprak, kërkesa e fortë globale për import të bulmetit dhe oferta e kufizuar rezultuan në rritje të çmimeve prej 4.5 përqind për këtë kategori. Kurse, çmimet e vajrave dhe mishit, përkundër luhatjeve përgjatë tremujorit, shënuan rënie prej 1.7 dhe 1.6 përqind respektivisht. Përmirësimi i kushteve klimatike dhe rrjedhimisht pritjeve për rritjen e rendimentit të sheqerit ndikuan që çmimi të bie për 7.6 përqind. Kurse, çmimet e drithërave mbetën pothuajse të pandryshuara me rënie të lehtë prej 0.9 përqind.

Grafik 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit




Burimi: FAO.

## 3. Ekonomia e Kosovës

### 3.1. Rritja Ekonomike

Ekonomia e Kosovës gjatë TM1 2025 ka shënuar rritje më të ngadalësuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Sipas të dhënave të ASK-së, BPV reale shënoi rritje prej 3.6 përqind, krahasuar me rritjen prej 5.6 përqind në TM1 2024 (grafiku 4). Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik reflekton kryesisht ndikimin e rritjes më të ngadalësuar të konsumit, rënies së eksportit të mallrave, si dhe rritjes së importit të mallrave. Ndërkohë, investimet dhe eksporti i shërbimeve ishin kontribuuesit kryesor të rritjes.

Grafik 4. Rritja reale e BPV-së



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.

Shpenzimet e konsumit final shënuan rritje për 5.2 përqind, krahasuar me rritjen prej 8.6 përqind në TM1 2024. Konsumi privat shënoi rritje prej 4.3 përqind, më ulët se rritja prej 9.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, për shkak të rritjes më të ngadaltë të burimeve të financimit, përfshirë kreditë konsumuese, kompensimin e punëtorëve, remitencat, etj. Në anën tjetër, shpenzimet e konsumit publik shënuan rritje prej 11.6 përqind, në krahasim me 2.5 përqind në TM1 2024, si rezultat i rritjes së shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë.


Investimet shënuan rritje të konsiderueshme prej 13.6 përqind, shumë më e lartë krahasuar me rritjen prej 2.6 përqind në TM1 2024. Kjo rritje reflekton kryesisht rritjen e kreditimit dhe investimeve publike. Indikacion i rritjes së investimeve është rritja e importit të mallrave kapitale dhe IHD-ve në sektorin e patundshmërive.

Eksporti neto ka vazhduar të kontribuoi negativisht në rritjen ekonomike, ndonëse eksporti i mallrave dhe shërbimeve është rritur me 12.1 përqind, krahasuar me rritjen prej 10.1 përqind në TM1 2024. Brenda kësaj kategorie, eksporti i shërbimeve shënoi rritje të dukshme prej 18.9 përqind, ku eksporti i shërbimeve të udhëtimit është kontribuuesi kryesor, me rritje nominale prej 12.5 përqind. Në anën tjetër, eksporti i mallrave shënoi rënie për 6.4 përqind, kryesisht për shkak të rënies së eksportit të metaleve bazë dhe produkteve ushqimore. Po ashtu, importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rritje për 14.4 përqind, më shumë se rritja prej 10.8 përqind në TM1 2024. Rritja e importeve të mallrave (me 17.7 përqind) dhe e shërbimeve (me vetëm 0.3 përqind) tregon kërkesën e lartë vendore për mallra të konsumit dhe investimeve, pavarësisht ngadalësimit të rritjes së konsumit.

Aktiviteti ekonomik është mbështetur nga disa sektorë të ndryshëm, me performancë të ndryshme gjatë TM1 2025. Sektori i ndërtimit shënoi rritje prej 9.8 përqind, duke kontribuar ndjeshëm në aktivitetin ekonomik. Sektori i tregtisë dhe ai i industrisë përpunuese gjithashtu kanë pasur performancë pozitive, me rritje prej 4.5 përqind, si rezultat i kërkesës së lartë vendore. Në anën tjetër, sektori i energjisë elektrike shënoi rënie të dukshme prej 8.0 përqind, duke pasur ndikimi negativ në dinamikën e përgjithshme të ekonomisë. Ky ngadalësim është reflektuar edhe në trendet e regjistrimit të ndërmarrjeve të reja, ku në TM1 2025 u regjistruan 3,015 ndërmarrje apo 7.2 përqind më pak krahasuar me TM1 2024. Sektorët që ndikuan më shumë

ishin tregtia, bujqësia, prodhimi dhe transporti, ku numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte më i ulët krahasuar me TM1 2024. Megjithatë, disa sektorë shfaqën tendencë pozitive në regjistrimin e ndërmarrjeve. Sektorët e aktiviteteve profesionale, hotelierisë, arsimit, energjisë, ndërtimtarisë, aktiviteteve administrative dhe aktiviteteve me patundshmëri shënuan rritje në numrin e ndërmarrjeve të regjistruara (grafiku 5). Gjithashtu, numri i ndërmarrjeve të mbyllura shënoi rënie prej 13.6 përqind, duke arritur në 342 ndërmarrje.

Grafik 5. Numri i ndërmarrjeve të reja




Burimi: ASK.

Në përgjithësi, TM1 2025 karakterizohet nga një rritje ekonomike më e matur, e mbështetur nga investimet dhe eksporti i shërbimeve, ndërsa sfidat kryesore mbeten në uljen e deficitit tregtar. Sa i përket vitit 2025, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se ekonomia do të rritet me 4.1 përqind, me kontribuues kryesor konsumin, investimet si dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve. Pritet që importi i mallrave dhe shërbimeve të ketë ndikim negativ në rritjen ekonomike.

### 3.2. Çmimet

**Inflacioni në TM1 2025 u përshpejtua në 2.0 përqind nga 0.7 përqind në tremujorin paraprak.** Gjatë këtij tremujori, u vunë re presione të shtuara inflacioniste, me normën vjetore që arriti në 2.9 përqind në mars 2025. Kjo rritje u ndikua kryesisht nga rritja e çmimeve të ushqimit, përderisa u evidentuan presione inflacioniste edhe në kategoritë e mallrave tjera dhe shërbimeve (grafiku 6). Megjithëse me rënie vjetore, edhe çmimet e energjisë kontribuuan në rritjen e inflacionit pasi u zbeh kontributi negativ i kësaj komponente.

Grafik 6. Inflacioni sipas kontributit të nëngrupeve përkatëse



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

**Çmimet e ushqimit shënuan rritje vjetore prej 4.2 përqind në TM1 2025, duke reflektuar një përshpejtim krahasuar me 2.3 përqind në tremujorin paraprak.** Në linjë me tendencat në tregjet ndërkombëtare, rritja më e shpejtë e çmimeve të vajrave (9.7 përqind), mishit (6.2 përqind), bulmetit (4.9 përqind) dhe perimeve (4.5 përqind) përbënë faktorët kryesorë që ushtruan presion mbi inflacionin.


**Çmimet e karburanteve shënuan rënie vjetore prej 4.4 përqind.** Megjithatë, ecuria rritëse e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare në terma tremujorë u reflektua edhe në vend, me rritje prej 2.9 përqind krahasuar me tremujorin paraprak. Ngjashëm, çmimet e energjisë elektrike shënuan rënie vjetore prej 0.4 përqind, ndërsa në raport me tremujorin paraprak u regjistrua një rritje prej 4.6 përqind. Ky ndryshim mund të jetë ndikuar nga rritja sezonale e konsumit të energjisë elektrike për ngrohje gjatë muajve të dimrit, pasi rritje u evidentua edhe në çmimet e lëndëve djegëse të ngurta.

**Kontributi i ushqimit në normën mesatare të inflacionit në TM1 2025 u rrit në 1.1 pikë përqindje kundrejt 0.7 pikë përqindje në tremujorin paraprak.** Kontribuuesit kryesor në inflacionin e ushqimit ishin

çmimet e mishit me 0.4 pikë përqindje dhe bulmetit me 0.3 pikë përqindje. Kontributi i energjisë u zvogëlua për -0.4 pikë përqindje nga -0.9 pikë përqindje në tremujorin paraprak, si rrjedhojë e rënies më të zbehtë të çmimeve të naftës. Kontributi i çmimeve të mallrave tjera u rrit për 0.2 pikë përqindje nga rënia e ngadalësuar e çmimeve të automjeteve, rritja e përshpejtuar e çmimeve të alkoolit dhe duhanit, veshmbathjes, si dhe në shkallë më të ulët nga rritja e çmimeve të mallrave tjera si ato mjekësore, shkollore, kujdesi personal, e të tjera. Ndërsa, kontributi i shërbimeve u rrit për 0.1 pikë përqindje nga rritja e çmimeve të shërbimeve hoteliere dhe atyre ambulatore, që megjithatë u neutralizuan paksa nga rënia vjetore e çmimeve të shërbimeve të transportit.

**Rritja e presioneve inflacioniste është reflektuar edhe në inflacionin bazë, që rezultoi 1.0 përqind në TM1 2025.** Megjithëse më i ulët për 0.7 pikë përqindje krahasuar me TM4 2024 (grafik 7), inflacioni bazë shfaq tendencë rritëse përgjatë tremujorit të parë, duke arritur në 2.0 përqind në muajin mars.<sup>1</sup> Rritje më të theksuar kanë shënuar çmimet në sektorin e restoranteve, të ndikuara nga çmimet më të larta të ushqimit si dhe efektet sezonale në mars 2025. Rritje çmimesh u evidentua gjithashtu në kategori të tjera si orenditë, veshmbathja, mallrat dhe shërbimet për kujdes personal, e të tjera. Në anën tjetër, rënie u evidentua vetëm në çmimet e shërbimeve të transportit dhe pajisjeve dhe shërbimeve të komunikimit.

**Grafik 7. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit**



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

**Sa i përket origjinës së inflacionit, rritja e presioneve të huaja inflacioniste u reflektua në rritjen e kontributit të inflacionit të importuar në 1.8 nga 0.5 pikë përqindje në TM4 2024.** Kjo rritje reflekton kryesisht kontributin e shtuar në inflacion nga rritja e çmimeve të ushqimit dhe mallrave tjera të importuara. Edhe pse presionet inflacioniste në çmimet e shërbimeve ishin të pranishme, rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit ndikoi që kontributi i inflacionit të brendshëm të mbetet i pandryshuar në 0.2 pikë përqindje.

**Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP), sipas të dhënave të ASK-së, shënoi një rënie vjetore prej 1.9 përqind.** Kjo rënie reflekton rënien e çmimeve në shumicën e kategorive të mallrave të importuara në shportën e këtij indeksi. Rënie të theksuar pësuan çmimet e produkteve minerale prej 8.1 përqind, ndërsa ato të metaleve bazë shënuan rënie prej 3.8 përqind, duke reflektuar dinamikat e dobësimit të kërkesës globale. Çmimet e artikujve ushqimorë të përpunuar regjistruan një rënie të lehtë prej 0.1 përqind në terma vjetorë. Në anën tjetër, çmimet e produkteve bimore shënuan rritje vjetore prej 4.2 përqind, dhe ato të shtazëve të gjalla dhe produkteve të tyre prej 1.2 përqind, gjë që u reflektua edhe në çmimet e këtyre kategorive në Kosovë.

**Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) në TM1 2025 shënoi rritje vjetore prej 8.8 përqind.** Çmimet e komponentëve kryesorë, si prodhimi i energjisë elektrike, përpunimi i produkteve ushqimore, dhe prodhimi i produkteve minerale jometalike shënuan rritje prej 25.1 përqind, 3.6 përqind, dhe 0.8 përqind respektivisht. Megjithatë, kundrejt tremujorit paraprak, IÇP regjistroi rënie të lehtë prej 0.1 përqind.

<sup>1</sup> Inflacioni bazë për vitin 2024 është rishikuar pas rishikimit të peshave në kuadër të shportës së konsumit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në maj 2025.

**Në anën tjetër, indeksi i kostos së ndërtimit (IKN) shënoi rritje vjetore prej 6.5 përqind.** Kjo rritje u gjenerua kryesisht nga rritja vjetore e çmimeve të materialeve ndërtimore (4.1 përqind), pagave (13.5 përqind), energjisë elektrike (14.6 përqind) dhe transportit (5.2 përqind).

**Sipas parashikimeve të BQK-së, norma e përgjithshme e inflacionit pritet të jetë rreth 3.3 përqind në vitin 2025.** Çmimet e ushqimit mbeten nxitësi kryesor i presioneve inflacioniste. Megjithatë, rënia e parashikuar e çmimeve të ushqimit në tregjet ndërkombëtare mund të reflektohet edhe në vend përmes kanaleve të importit. Sidoqoftë, rreziqet që mund të ndikojnë këto projeksione mbeten të theksuara, veçanërisht ato që lidhen me pasiguritë gjeopolitike, ndikimin e rritjes së tarifave të energjisë elektrike në sektorët tjerë, barrierat tregtare ndaj vendit dhe partnerëve tregtarë, dhe ndikimet klimatike.


### 3.3 Sektori Fiskal

Të hyrat primare buxhetore<sup>2</sup> në TM1 2025 arritën vlerën neto prej 709.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore më të ngadalësuar prej 2.3 përqind. Ndërkohë, shpenzimet buxhetore<sup>3</sup> shënuan rritje të përshpejtuar prej 18.3 përqind, duke arritur në 677.4 milionë euro. Përkundër rritjes më të lartë të shpenzimeve, niveli më i lartë i të hyrave rezultoi në suficit primar buxhetor prej 46.0 milionë euro.

**Të hyrat tatimore në TM1 2025 arritën në 641.7 milionë euro, duke shënuar rritje prej 2.4 përqind krahasuar me TM1 2024.** Gjatë kësaj periudhe, shumica e kategorive tatimore shënuan rritje më të ngadalësuar. Të hyrat nga tatimet direkte shënuan rritje prej 4.0 përqind, duke arritur në 130.7 milionë euro. Brenda kësaj kategorie, të hyrat nga tatimi në të ardhurat e korporatave shënuan rritje më të lartë prej 5.3 përqind, tatimi në të ardhurat personale u rrit me 2.2 përqind, ndërsa tatimi në pronë pati rritje prej 14.3 përqind.

**Të hyrat nga tatimet indirekte shënuan rritje prej 2.5 përqind, duke arritur në 526.1 milionë euro, që përbëjnë 74.1 përqind të gjithë të hyrave buxhetore.** Kjo rritje u ndikua kryesisht nga rritja e të hyrave nga TVSH-ja për 9.0 përqind, duke arritur nivelin prej 361.9 milionë euro, si dhe nga detyrimi doganor që u rrit për 13.3 përqind. Në anën tjetër, akciza shënoi rënie prej 14.8 përqind (grafiku 8). **Të hyrat jo-tatimore shënuan rritje më të ngadalësuar prej 1.6 përqind, duke arritur në 66.3 milionë euro.** Kjo kategori përfshinë të hyrat nga qeveria qendrore, të cilat shënuan rënie prej 13.1 përqind, duke arritur në 34.4 milionë euro, ndërsa të hyrat nga qeveria lokale shënuan rritje për 24.1 përqind, duke arritur në 16.4 milionë euro.

Grafik 8. Të hyrat tatimore sipas kategorive, në milionë euro



Burimi: MFPT.

**Sa i përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje prej 19.4 përqind.** Brenda kësaj kategorie, shpenzimet për subvencione dhe transfere, si kategoria kryesore, shënuan rritje prej 34.4 përqind, duke arritur vlerën 252.8 milionë euro. Shpenzimet për mallra dhe shërbime, përfshirë shpenzimet komunale, shënuan rritje prej 35.8 përqind dhe arritën në 95.9 milionë euro. Shpenzimet për paga shënuan


<sup>2</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë pranimet nga huazimet shtetërore.

<sup>3</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat për financim.

rritje më të ulët prej 1.8 përqind, duke arritur në 219.5 milionë euro. **Shpenzimet kapitale shënuan rritje më të ulët krahasuar me shpenzimet rrjedhëse, duke arritur në 97.7 milionë euro, që është një rritje prej 11.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafiku 9).**

**Raporti i borxhit publik ndaj BPV-së u ul në 15.3 përqind në TM1 2025, krahasuar me 15.6 përqind në TM1 2024.** Kjo ulje e raportit të borxhit publik në tremujorin e fundit të vitit ishte rezultat i rritjes së bilancit buxhetor të qeverisë, duke zvogëluar nevojën për borxh, si dhe rritjes nominale të BPV-së. Në terma absolut, borxhi publik ishte 1.7 miliardë euro në TM1 2025, duke shënuar rritje prej 3.1 përqind krahasuar me TM1 2024. Kjo rritje u ndikua nga borxhi i jashtëm publik, i cili shënoi rritje për 8.7 përqind, duke arritur në 758.8 milionë euro. Ndërkohë, borxhi i brendshëm publik shënoi rënie prej 1.1 përqind, duke arritur në 934.7 milionë euro.

Grafik 09. Shpenzimet buxhetore sipas kategorive, në milionë euro




Burimi: MFPT.

Borxhi i jashtëm publik përfshin detyrime ndaj institucioneve ndërkombëtare, si Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (me 35 përqind të borxhit të jashtëm), Bashkimi Evropian (13 përqind), Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (10 përqind), Fondi Monetar Ndërkombëtar (9 përqind), etj. Ndërsa, borxhi i brendshëm publik përfshin kryesisht borxhin e Qeverisë së Kosovës (letrat me vlerë) ndaj fondeve pensionale (46 përqind), bankave komerciale (21 përqind), institucioneve publike (24 përqind), etj.

### 3.4. Sektori i jashtëm

**Në TM1 2025, deficitin e llogarisë rrjedhëse shënoi rritje prej 9.5 përqind, duke arritur në 347.6 milionë euro (15.8 përqind e BPV-së).** Kjo rritje erdhi si pasojë e zgjerimit të mëtejshëm të deficitit tregtar të mallrave, që reflekton rritje më të shpejtë të importit në raport me eksportin. Ndërkohë, të ardhurat parësore dhe dytësore, së bashku me shërbimet, sidomos ato nga udhëtimi, kontribuan pozitivisht në zbutjen e këtij deficitit (Grafiku 10). Përkundër këtij ndikimi balancues, të ardhurat nga këto komponentë nuk arritën të neutralizojnë plotësisht efektin negativ të shkaktuar nga përkeqësimi i bilancit të mallrave.


Grafik 10. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK.


**Deficiti tregtar i mallrave në TM1 2025 shënoi rritje prej 20.8 përqind, duke arritur vlerën 1.4 miliardë euro, si pasojë e rritjes së vazhdueshme të importit të mallrave (Grafiku 11).** Vlera e importit të mallrave u zgjerua në 1.6 miliardë euro, kryesisht nga rritja e sasisë së mallrave të importuara të produkteve minerale dhe mjeteve të transportit. Në anën tjetër, eksportet mbetën në nivele të ulëta, duke arritur në 201.7 milionë euro, që mbulojnë vetëm 12.6 përqind të importeve, që pasqyron thellim të mëtejshëm të deficitit të bilancit tregtar. Ky raport i pafavorshëm tregtar 1:7.9 tregon varësinë e lartë nga importet dhe kapacitetet e kufizuara eksportuese, duke shtuar sfidat strukturore për ekonominë. Kërkesa e lartë për mallra të huaja nënvizon varësinë e vazhdueshme nga tregjet ndërkombëtare për mbulimin e nevojave të brendshme dhe ekspozimi e ekonomisë ndaj luhatjeve dhe rreziqeve të jashtme.

Grafik 11. Bilanci tregtar i mallrave



**Eksporti i mallrave shënoi rënie prej 4.5 përqind në TM1 2025, kryesisht për shkak të performancës së dobët të disa prej kategorive kryesore si metalet bazë dhe artikujt tjerë të prodhuar (Grafiku 12).** Metalet bazë, për shembull, shënuan rënie prej 10.2 përqind, duke kontribuar me -2.7 pikë përqindje në gjithsej eksportin. Kjo rënie reflekton uljen e kërkesës dhe stabilizimin e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Po ashtu, artikujt tjerë të prodhuar shënuan rënie prej 19.1 përqind, duke kontribuar me -2.6 pikë përqindje në rënien e përgjithshme të eksportit. Megjithatë, produktet minerale, tekstili dhe artikujt ushqimor kontribuan pozitivisht, duke zbutur pjesërisht efektin negativ të kategorive të tjera dhe duke treguar mbështetje të pjesshme për eksportin e përgjithshëm të mallrave gjatë kësaj periudhe.


Grafik 12. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Nga këndvështrimi gjeografik, Ballkani Perëndimor mbetet partneri kryesor, me 42.9 përqind të gjithsej eksporteve, me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut si destinacionet kryesore. Ndërsa vendet e BE-së përbëjnë 36.2 përqind të eksportit të përgjithshëm, me destinacionin kryesor Gjermaninë. Kjo tregon varësi të theksuar ndaj tregut rajonal, por gjithashtu një mundësi për zgjerim dhe integrim në zinxhirët globalë të furnizimit.

**Importi i mallrave shënoi rritje dyshifrore prej 16.9 përqind, duke arritur vlerën prej 1.6 miliardë euro (72.7 përqind e BPV-së).** Kjo rritje u mbështet kryesisht nga importi i produkteve minerale, të cilat kontribuan me 5.7 pikë përqindje në rritjen e importit, duke shënuar rritje vjetore prej 38.9 përqind dhe arritur vlerën prej 280.7 milionë euro. Brenda kësaj kategorie, veçohet importi i energjisë elektrike, i cili, sipas të dhënave nga Dogana e Kosovës, arriti vlerën prej 126.2 milionë euro në TM1 2025. Përveç produkteve minerale, rritja e importit u mbështet edhe nga importi i mjeteve të transportit, të cilat kontribuan me 2.7 pikë përqindje, duke shënuar rritje prej 24.4 përqind, dhe arritur në 187.6 milionë euro, mbështetur nga importi i veturave nga Koreja e Jugut (Grafiku 13). Vendet e BE-së përfaqësojnë rreth 42.6 përqind të importeve, ndërsa vendet e rajonit përbëjnë 16.8 përqind të importeve.


**Grafik 13. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro**



Burimi:


**Bilanci i shërbimeve arriti në 368.4 milionë euro, duke regjistruar rritje vjetore të konsiderueshme prej 35.8 përqind, ndjeshëm më e lartë krahasuar me rritjen prej 4.7 përqind në TM1 2024 (Grafiku 14).** Eksporti i shërbimeve arriti në 670.6 milionë euro, duke shënuar rritje prej 17.3 përqind në terma vjetorë, e mbështetur kryesisht nga shërbimet e udhëtimit. Kjo kategori, e cila përfaqëson pjesën më të madhe të eksportit të shërbimeve, u rrit me 19.1 përqind, duke arritur në 442.5 milionë euro, si rezultat i rritjes së numrit të udhëtarëve dhe vizitave nga diaspora. Kontribut pozitiv u dha edhe nga eksporti i shërbimeve kompjuterike, të informacionit dhe telekomunikacionit, me rritje prej 23.0 përqind, duke arritur në 90.4 milionë euro. Nga ana tjetër, importi i shërbimeve arriti vlerën prej 302.2 milionë euro dhe shënoi rritje modeste prej vetëm 0.6 përqind, për shkak të efektit bazë të krijuar nga liberalizimi i vizave në vitin e kaluar, i cili kishte gjeneruar rritje prej 29.0 përqind. Si rrjedhojë, importi i shërbimeve të udhëtimit shënoi rënie prej 8.6 përqind, duke zbritur në 120.4 milionë euro. Për dallim nga shërbimet e udhëtimit, shërbimet e transportit regjistruan trend pozitiv, me rritje prej 31.3 përqind, duke arritur në 80.2 milionë euro. Zgjerimi i qëndrueshëm i eksportit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve të tjera të

**Grafik 14. Bilanci i shërbimeve**



Burimi: BQK.

**Grafik 15. Bilanci i të ardhurave parësore**



Burimi: BQK.


Zgjerimi i qëndrueshëm i eksportit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve të tjera të

biznesit përfaqëson një indikator të rëndësishëm të transformimit strukturor në sektorin e shërbimeve dhe të tendencës drejt diversifikimit të portofolit eksportues të ekonomisë.

**Bilanci i të ardhurave parësore në TM1 2025 arriti vlerën prej 110.7 milionë euro, duke shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin e kaluar (Grafiku 15).** Kompensimi i punëtorëve ka kontribuar ndjeshëm në këtë përmirësim, me rritje vjetore prej 16.9 përqind, duke arritur në 112.7 milionë euro. Nga ana tjetër, bilanci i të ardhurave nga investimet vazhdoi të mbetet negativ, duke shënuar vlerën prej 3.9 milionë euro, për shkak të fitimeve të riinvestuara nga investimet e huaja direkte.

**Remitencat vazhduan trendin e rritjes edhe në TM1 2025, megjithëse me ritëm më të ngadalësuar prej 3.6 përqind duke arritur vlerën prej 291.3 milion euro (Grafiku 16).** Kjo rritje u regjistrua si në kanalet formale, të cilat shënuan rritje prej 3.6 përqind dhe në kanalet joformale, me rritje prej 4.0 përqind. Gjermania dhe Zvicra vazhdojnë të jenë burimet kryesore të remitencave, të cilat përbëjnë 56.5 përqind të gjithsej remitencave, e ndjekur nga SHBA-të dhe vendet tjera të BE-së. Ngadalësimi i ritmit të rritjes së remitencave, krahasuar me periudhat e mëparshme kur rritja ishte dyshifrore, mund të jetë rezultat i efektit bazë, duke qenë se remitencat tashmë kanë arritur nivel të lartë, gjë që e bën më të vështirë mbajtjen e normave të larta të rritjes.


Grafik 16. Remitencat



Burimi: BQK.

**Investimet e huaja direkte arritën vlerën 197.6 milionë euro, duke shënuar rënie prej 8.1 përqind (Grafiku 17).** Megjithatë, ritmi i rënies u ngadalësua pjesërisht nga rritja e investimeve në sektorin e patundshmërisë. Investimet në këtë sektor u rritën me 11.7 përqind, duke arritur në 158.9 milionë euro (80.4 përqind e gjithsej IHD-ve), kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe kërkesës së lartë për patundshmëri. Në anën tjetër, investimet direkte të rezidentëve nga Kosova jashtë vendit shënuan rritje të dukshme gjatë TM1 2025, duke arritur në 74.3 milionë euro, krahasuar me 37.3 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit 2024. Këto investime ishin kryesisht të orientuara në sektorin e patundshmërisë në vendet e rajonit, duke reflektuar kërkesën në rritje për investime jashtë vendit.

Grafik 17. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

## 4. Sistemi financiar

Në TM1 2025, sistemi financiar në vend ka shënuar rritje të lartë, duke vijuar trendin e rritjes së përshpejtuar të filluar në gjysmën e dytë të vitit të kaluar. Vlera e tyre arriti në 12.85 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.4 përqind (grafiku 18). Sektori bankar dhe ndihmësit financiar u karakterizuan me rritje vjetore të përshpejtuar, ndërsa sektori i fondeve pensionale, sigurimeve dhe ai mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar shënuan rritje vjetore më të ngadalësuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.


Në mars 2025, sektori bankar përbënte 67.2 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, ndaj dhe për shkak të peshës së theksuar kishte kontributin kryesor në zgjerimin e përshpejtuar të sistemit financiar (grafiku 19). Në anën tjetër, fondet pensionale shënuan rritje të ngadalësuar prej 11.9 përqind nga 16.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, dhe si rezultat shënuan rënie të pjesëmarrjes në kuadër të sistemit financiar për 0.6 pikë përqindje, duke zbritur në 25.0 përqind. Po ashtu, sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar, si dhe ai i sigurimeve shënuan rritje të ngadalësuar prej 17.5 përqind dhe 8.1 përqind, nga 31.2 përqind dhe 9.0 përqind, respektivisht. Ndërsa, sektori i ndihmësve financiar ka shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 38.1 përqind, pas rënies së theksuar prej 66.8 përqind në vitin e kaluar që ishte pasojë e riklasifikimit të dy operatorëve nga ndihmës financiarë në IMF/IFJB. Megjithatë, për shkak të peshës së ulët të këtij sektori, kontributi në rritjen e përgjithshme ishte marginal.

### 4.1. Sektori bankar


Asetet e sektorit bankar arritën në 8.63 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 15.4 përqind nga 10.6 përqind në mars të vitit paraprak (grafiku 20). Kjo dinamikë në asete reflekton zgjerimin e përshpejtuar të aktivitetit kreditues, i cili përfaqëson 70.9 përqind të gjithsej vlerës së aseteve.

Në kuadër të zërave tjerë të aseteve, paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënuan rritje vjetore të përshpejtuar prej 14.0 përqind nga 5.2 përqind një vit më parë. Ndërkohë, investimet në letra me vlerë shënuan tkurrje të lehtë prej 0.6 përqind


Grafik 18. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës



Grafik 19. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje



Grafik 20. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet




nga rritja prej 26.1 përqind në vitin paraprak, kryesisht si rezultat i rënies së investimeve në letrat me vlerë vendore. Ky zhvillim, ndër tjera, reflekton një zhvendosje strategjike të sektorit drejt mbështetjes së kreditimit, në vend të mbajtjes së pozicioneve në letra me vlerë vendore me kthim relativ më të ulët. Pozicioni i bilancit me bankat komerciale mbeti pothuajse i pandryshuar nga viti paraprak, me rënie marginale prej vetëm 0.03 përqind.

**Stoku i gjithsej kredive arriti në 6.12 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 20.3 përqind nga 12.8 përqind në mars të vitit paraprak.** Kjo dinamikë në aktivitetin kreditues është mbështetur nga rritja e theksuar e kredive që nga gjysma e dytë e vitit të kaluar, e që ka vazhduar edhe në tremujorin e parë të këtij viti, si për segmentin e korporatave jofinanciare ashtu edhe për ekonominë familjare (grafiku 21 dhe 22). Sipas Anketës së Kreditimit Bankar, në TM1 2025, rritja e kreditimit u mbështet kryesisht nga kërkesa e lartë për kredi e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, e shoqëruar me lehtësim në anën e ofertës kreditore, kryesisht përmes rritjes së nivelit të aprovimeve dhe në një masë më të vogël përmes lehtësimit të kushteve dhe rregullave të aplikuara me theks të veçantë për NVM-të dhe ekonominë familjare në përgjithësi.

Niveli i aprovimit të kredive u rrit për të dy sektorët – ndërmarrjet dhe ekonominë familjare – e veçanërisht për NVM-të dhe kreditë konsumuese. Kushtet dhe rregullat u lehtësuan kryesisht për NVM-të, nëpërmjet uljes së kërkesave për kolateral dhe rritjes së madhësisë së kredive. Për ekonominë familjare, për kreditë për blerjen e shtëpive kishte lehtësim të maturitetit dhe kërkesës për kolateral, dhe për kreditë konsumuese kishte rritje në madhësinë dhe maturitetin e kredive. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet u rrit në të dy segmentet, ndonëse në një nivel më të ulët krahasuar me tremujorin paraprak. Në anën tjetër, ekonominë familjare shënuar rritje më të shpejtë të kërkesës kreditore, konkretisht kërkesë më të lartë për kreditë për blerjen e shtëpive sesa për kredi konsumuese. Nxitësit kryesorë të kësaj rritjeje ishin financimi i inventarëve dhe kapitalit punues për ndërmarrjet, ndërsa zhvillimet pozitive në tregun e patundshmërive, shpenzimet e konsumit dhe besueshmëria e konsumatorëve për ekonominë familjare. Në TM2 2025, oferta kreditore pritet të lehtësohet deri në një masë për NVM-të në kuadër të ndërmarrjeve, si dhe për ekonominë familjare në përgjithësi. Ndërsa, kërkesa për kredi pritet të shënoj rritje të lartë nga të dy segmentet.


Kontributin kryesor në zgjerimin e kreditimit të sektorit bankar e kishte segmenti i korporatave jo-financiare, i cili vazhdon të dominojnë strukturën e gjithsej kredive. Megjithatë, segmenti i ekonomive familjare është duke zgjeruar relativisht shpejtë pjesëmarrjen, si rezultat i rritjes më të lartë të stokut të kredive me afate më të gjata maturimi. Rritja e qëndrueshme e kreditimit është shoqëruar me zgjerimin e bazës së përgjithshme të

Grafik 21. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

Grafik 22. Kontributi në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje




Burimi: BQK.

kredimarrësve duke reflektuar zgjerim të mëtejshëm të ndërmjetësimit financiar. Numri i kredimarrësve të rinj u rrit për 14.7 përqind në TM1 2025, kundrejt rritjes prej 7.4 përqind në të njëjtën periudhë të vitit paraprak.<sup>4</sup>


**Kreditë për segmentin e korporatave jo-financiare arritën në 3.57 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 17.0 përqind, pas ngadalësimit të rritjes në 9.5 përqind në vitin paraprak. Kjo dinamikë është ndikuar nga rritja e lartë e kredive të reja, me theks të veçantë atyre investuese.** Aktiviteti kreditues i KJF-ve sipas sektorëve ekonomik, u karakterizua me përshpejtim të rritjes për sektorin e tregtisë me shumicë, i cili shënoi rritje vjetore prej 18.6 përqind nga 8.9 përqind në vitin paraprak dhe njëherësh mbetet kategoria me kontributin më të madh në dinamikën e kredive të ndërmarrjeve, falë peshës së tij dominuese prej 42.7 përqind (grafik 23). Po ashtu, sektori i prodhimitarisë dhe ai shërbimeve financiare shënuan rritje vjetore të përshpejtuar prej 19.5 përqind dhe 28.9 përqind, nga 1.0 përqind dhe 11.1 përqind, respektivisht (grafik 24). Sektori i ndërtimtarisë ka shënuar ngadalësim të rritjes vjetore për 14.2 pikë përqindje, duke zbritur në 7.0 përqind. Ndërsa, bujqësia shënoi rënie vjetore prej 2.4 përqind krahasuar me rritjen prej 16.8 përqind në vitin paraprak. Dinamikat e kreditimit ndaj KJF-ve në sektor të caktuar, si tregtia me shumicë dhe prodhimitaria, reflektojnë deri në një masë rritjen e vlerës së shtuar në bruto produktin vendor të këtyre sektorëve. Ndërsa, për sektorin e bujqësisë dhe ndërtimtarisë, përkundër rritjes së aktivitetit ekonomik të këtyre sektorëve, kreditimi u karakterizua me rënie, përkatësisht me ngadalësim të rritjes vjetore. Kreditë e reja për korporatat jo-financiare, shënuan rritje të theksuar prej 46.3 përqind nga rritja prej vetëm 1.4 përqind vitin e kaluar. Ky përshpejtim i rritjes u ndikua kryesisht nga rritja e kredive të reja për qëllime investive, të cilat shënuan rritje prej 63.8 përqind, krahasuar me 3.7 përqind një vit më parë. Në kuadër të kredive të reja investuese, me rritje të lartë u karakterizuan kreditë e reja investuese për sektorin e shërbimeve dhe industrisë, të cilat shënuan rritje prej 102.7 përqind dhe 63.7 përqind, përkatësisht. Po ashtu, për dallim nga tremujori paraprak dhe nga marsi i vitit të kaluar, kreditë për qëllime jo-investive rikthyen trendin pozitiv të rritjes, duke shënuar rritje prej 12.5 përqind nga rënia prej 2.8 përqind në vitin e kaluar.

**Stoku i kredive për ekonomitë familjare arriti në 2.48 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore të përshpejtuar në 24.3 përqind nga 17.9 përqind në vitin paraprak.** Kontributin kryesor në këtë rritje e kishin kreditë e reja hipotekare, të cilat shënuan rritje vjetore të përshpejtuar prej 74.4 përqind nga 14.1

Grafik 23. Kontributi në rritjen e gjithsej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik




Grafik 24. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



<sup>4</sup> Numri i kredimarrësve të rinj në databazën e Regjistrit të Kredive të Kosovës.

përçind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, kreditë e reja konsumuese shënuan rritje më të ngadalësuar prej 20.0 përçind nga 31.5 përçind në vitin paraprak, si rrjedhojë e efektit të bazës së rritjes më të lartë në vitin e kaluar. Rritja e theksuar e kredive të reja hipotekare është reflektuar ndër të tjera edhe në strukturën e maturimit të kredive të stokut të kredive të ekonomive familjare, të cilat po orientohen gjithnjë e më shumë drejt kredive me afat më të gjatë maturimi dhe me shuma më të larta. Konkretisht, kategoria ‘mbi 10 vite’ ka zgjeruar pjesëmarrjen në 37.2 përçind, për 2.0 pikë përçindje më e lartë se një vit më parë, dhe krahasuar me pesë vite më parë është rritur për 17.9 pikë përçindje. Gjithsesi, kategoria dominuese vazhdoi të jetë ajo e maturitetit ‘5 - 10 vite’, me pjesëmarrje prej 42.9 përçind.


Grafik 25. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.


Sipas të dhënave nga databaza e Regjistrit të Kredive të Kosovës (RKK), kreditë e reja të disbursuara për ekonomitë familjare gjatë periudhës janar-mars 2025 arritën një vlerë mesatare prej 7.3 mijë euro dhe afat mesatar maturimi prej 3.7 vjet, krahasuar me vlerën prej 6.4 mijë euro dhe maturitetin prej 3.5 vjet në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Grafik 25a. Kreditë e reja të EF sipas vlerës së disbursuar në RKK (%)



Burimi: Regjistri i Kredive të Kosovës.


25b. Kreditë e reja të EF sipas maturitetit në RKK (%)



Burimi: Regjistri i Kredive të Kosovës.


Më konkretisht, në aspekt të vlerës së kredive të reja të lëshuara në këtë periudhë, 31.7 përçind e tyre ishin në intervalin prej 500 euro - 10 mijë euro, krahasuar me 35.2 përçind në vitin paraprak, duke mbetur kategoria dominuese për ekonomitë familjare. Ndërsa, kreditë në intervalin 30-60 mijë, si dhe ato në shumë të barabartë ose mbi 60 mijë euro shënuan rritje të pjesëmarrjes, duke kontribuar në rritjen e vlerës mesatare të kredive të reja për ekonomitë familjare (grafik 25a). Në aspektin e maturitetit, kreditë me maturitet ‘5-10 vite’ përfaqësuan 32.3 përçind të vlerës totale të kredive të reja të disbursuara për ekonomi familjare. Ndërkohë, rritje si në numër ashtu edhe në vlerë të disbursuar, kanë shënuar kategoria e kredive të reja me maturitet ‘10-15 vite’ dhe ‘më shumë se 15 vite’, duke konfirmuar tendencën e një zhvendosje drejt financimeve me afate më të gjata dhe vlera më të larta (grafik 25b).

Grafik 26. Stoku i gjithsej depozitave



Burimi: BQK.

Grafik 26 a. Diferenca (mil. €) dhe ndryshimi i vlerës (%) së depozitave në kuartale




Burimi: BQK.

**Stoku i depozitave në sektorin bankar arriti në 6.97 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 15.2 përqind nga 8.9 përqind në mars 2024 (grafik 26).** Po ashtu, krahasuar me

tremujorin paraprak, depozitat shënuan rritje prej 0.7 përqind, për dallim nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar ku shënuan rënie prej 1.3 përqind (grafik 26 a). Kontributin kryesor në rritjen e gjithsej depozitave kishin depozitat e ekonomive familjare, të cilat përfaqësojnë rreth 66.5 përqind të gjithsej portfolios, dhe shënuan rritje vjetore të përshpejtuar prej 14.0 përqind nga 8.7 përqind në vitin paraprak. Po ashtu, depozitat prej korporatave jo-financiare përshpejtuan ritmin e rritjes në 14.9 përqind nga 12.4 përqind në vitin paraprak. Depozitat e korporatave të tjera financiare dhe ato të korporatave publike gjithashtu kontribuan ndjeshëm, duke shënuar rritje vjetore prej 27.4 përqind dhe 13.5 përqind, nga 16.2 përqind dhe -2.2 përqind, respektivisht (grafiku 27). Rritja e këtyre të fundit është ndikuar kryesisht nga depozitorët e mëdhenj, të cilët përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të rritjes në këto kategori, veçanërisht nga sektori i fondeve pensionale, kompanive të sigurimit dhe sektori i energjisë. Presionet konkurruese dhe nevoja për likuiditet nga bankat, ka ndikuar në ofrimin e normave më atraktive të interesit krahasuar me një vit më parë, gjë që ka ndikuar pozitivisht në rritjen e depozitave në përgjithësi. Në mars 2025, depozitat përbënin 80.7 përqind të gjithsej detyrimeve dhe ekuitetit të sektorit bankar, duke shënuar rënie vjetore për 0.1 pikë përqindje, kryesisht si rezultat i rritjes më të lartë të burimeve vetanake.


Grafik 27. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje



Burimi: BQK.

**Depozitat e reja, që përfshijnë vetëm depozitat e afatizuara, ngadalësuan ritmin e rritjes vjetore si për ekonomitë familjare, ashtu dhe për korporatat jo-financiare.** Ky ngadalësim lidhet kryesisht me efektin e bazës, pas nivelit të lartë të rritjes në vitin paraprak. Vlera e depozitave të reja arriti në 296.9 milionë euro në fund të marsit 2025, duke shënuar rritje vjetore prej 24.3 përqind nga 56.5 përqind në

Grafik 28. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

296.9 milionë euro në fund të marsit 2025, duke shënuar rritje vjetore prej 24.3 përqind nga 56.5 përqind në

vit më parë. Segmenti i ekonomive familjare ka ngadalësuar rritjen vjetore në 31.3 përqind nga 61.9 përqind në vitin paraprak. Po ashtu, depozitat e reja të korporatave jo-financiare, shënuan rritje të ngadalësuar prej 11.2 përqind nga 47.2 përqind në vitin e kaluar (grafiku 28).


**Norma e interesit në kredi ka vazhduar rënien edhe gjatë TM1 2025, rezultat ky i zbutjes së presioneve inflacioniste dhe uljes së mëtejshme të normës bazë të interesit nga Banka Qendrore Evropiane. Në anën tjetër, norma e interesit në depozita ka shënuar rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, mirëpo nga tremujori paraprak shënoi rënie.** Në mars të vitit 2025, norma e interesit në kredi zbriti në 5.7 përqind, krahasuar me 6.2 përqind në mars 2024, ndërsa nga dhjetori 2024 ka shënuar rënie për 0.2 pikë përqindje. Konkurrenca ndër-bankare për tërheqjen e depozitave dhe nevoja për likuiditet ka ndikuar në rritjen e normës së interesit të depozitave në 3.0 përqind nga 2.7 përqind në vitin paraprak, megjithatë nga dhjetori 2024 ka shënuar rënie për 0.4 pikë përqindje. Si rezultat i uljes së normave të interesit në kredi dhe rritjes së normës së interesit në depozita, margjina e interesit kredi-depozitë ka zbritur në 2.7 pikë përqindje në mars 2024, nga 3.5 pikë përqindje në mars të vitit paraprak. Ndërsa, nga dhjetori 2024 ka shënuar rritje për 0.2 pikë përqindje, si rezultat i rënies më të lartë të normës së interesit në depozita në raport me atë të rënies në kredi (grafiku 29). Trendi rënës i normës së Euribor-it ka ndikuar në strukturën e kredive sipas llojit të normave të interesit, duke nxitur rritjen e pjesëmarrjes së kredive me normë fikse në strukturën e përgjithshme të kredive pas trendit të vazhdueshëm rënës në katër vitet e fundit. Më konkretisht, në mars 2025, pjesëmarrja e kredive me normë fikse të interesit arriti në 70.5 përqind, nga 68.2 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa, nga tremujori paraprak kjo pjesëmarrje ka pësuar rritje marginale prej 0.1 pikë përqindje (grafiku 30).

Grafik 29. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK.

Grafik 30. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit




Burim: BQK.


**Në mars 2025, norma mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare zbriti në 6.0 përqind, duke shënuar rënie vjetore prej 0.6 pikë përqindje.** Ndërsa, krahasuar me tremujorin paraprak, norma mesatare e interesit për këtë segment ka qëndruar në nivel pothuajse të njëjtë, me një rritje marginale prej 0.01 pikë përqindje. Në kuadër të KJF-ve, norma mesatare e interesit për sektorin e shërbimeve dhe bujqësisë ka shënuar rënie krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, si dhe me fundin e tremujorit paraprak,

duke zbritur në një mesatare prej 5.7 përqind dhe 7.8 **përqind**, respektivisht (grafiku 31). Ndërsa, norma e interesit për sektorin e industrisë ka shënuar rënie vjetore për 0.4 pikë përqindje, duke zbritur në 6.2 përqind, por krahasuar me tremujorin e kaluar, kjo normë ka shënuar rritje për 0.2 pikë përqindje. **Norma mesatare e interesit për ekonomitë familjare zbriti në 5.3 përqind, duke shënuar rënie për 0.4 pikë përqindje krahasuar me marsin dhe dhjetorin e vitit paraprak.** Në kuadër të ekonomive familjare, norma më të favorshme u ofruan për kreditë hipotekare, me një mesatare prej 4.8 përqind, përderisa kreditë konsumuese në mesatare kishin normë interesi prej 5.6 përqind (grafiku 32). Krahasuar me tremujorin e kaluar, norma e interesit për kreditë hipotekare ka shënuar rënie për 0.1 pikë përqindje, ndërsa për ato konsumuese ka shënuar rënie për 0.5 pikë përqindje.

**Grafik 31. Norma e interesit në kredi për korporatat jo-financiare**




**Grafik 32. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare**



**Normat e interesit në depozita arritën në 3.0 përqind, duke shënuar rritje për 0.2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, ndërsa nga tremujori i kaluar shënuan rënie për 0.4 pikë përqindje.** Në mars 2025, norma mesatare e interesit në depozita për korporatat jo-financiare ka shënuar rritje vjetore për 0.1 pikë përqindje, duke arritur në 3.3 përqind (grafiku 33). Megjithatë, krahasuar me tremujorin paraprak, kjo normë ka shënuar rënie për 0.8 pikë përqindje. Për ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit në depozita ka shënuar rritje vjetore për 0.3 pikë përqindje, duke arritur në 2.8 përqind. Krahasuar me tremujorin e kaluar, kjo normë ka pësuar një rënie të lehtë prej 0.2 pikë përqindje.

**Grafik 33. Normat e interesit për depozita**



**Fitimi neto i sektorit bankar arriti në 43.1 milionë euro nga 43.5 sa ishte në vitin paraprak, duke shënuar rënie vjetore prej 0.9 përqind, krahasuar me rritjen prej 7.9 përqind një vit më parë.** Ky zhvillim pasqyron rritjen më të lartë të shpenzimeve kundrejt rritjes më të ngadalësuar të të hyrave. Gjithsej të hyrat arritën në 129.7 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.5 përqind, ndjeshëm më e ulët krahasuar me rritjen prej 25.2 përqind një vit më parë. Rritja e ngadalësuar e të hyrave u ndikua kryesisht nga të hyrat nga interesi, të cilat përbëjnë rreth 78.4 përqind të gjithsej të hyrave dhe shënuan rritje prej 12.1 përqind nga 31.3 përqind në vitin e kaluar. Më konkretisht, të hyrat nga interesi nga kreditë u rritën për 19.0 përqind nga 19.4 përqind në vitin paraprak, si rezultat i uljes së normës së interesit dhe efektit të bazës. Tutje, rënia e investimeve në letra me vlerë, ka ndikuar që të hyrat e interesit nga kjo kategori të zbresin në 7.9

milione euro nga 9.3 milionë në vitin paraprak. Po ashtu, të hyrat nga plasmanët me bankat shënuan rënie, duke zbritur në 3.8 milionë euro nga 5.8 milionë euro në mars të vitit të kaluar. Për dallim nga te hyrat nga interesi, kategoria e të hyrave nga jo interesi - kryesisht të hyra nga tarifat dhe komisionet - shënoi rritje vjetore të përshpejtuar prej 11.6 përqind nga 9.3 përqind një vit më parë, duke arritur vlerën prej 24.9 milionë euro në fund të marsit 2025.


**Shpenzimet e sektorit bankar arritën vlerën 86.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 18.9 përqind nga 38.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.** Kjo dinamikë u ndikua kryesisht nga rritja më e ulët e shpenzimeve të interesit, si dhe e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative. Më konkretisht, shpenzimet e interesit arritën në 17.7 milionë euro, duke shënuar ngadalësim të rritjes vjetore në 37.8 përqind nga 51.2 përqindpërqind në vitin paraprak, ndikuar nga rënia e normave të interesit në depozita dhe efektit të bazës së lartë nga viti i kaluar. Po ashtu, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative shënuan rritje vjetore më të ngadalësuar, prej 11.2 përqind nga 29.8 përqind në vitin paraprak, çka kryesisht i atribuohet ngadalësimit të rritjes së shpenzimeve për personel.

Rritja më e ulët e fitimit të sektorit në raport me rritjen e kapitalit, ndikoi që treguesi i Kthimit në Kapital të zbres lehtësisht në 18.9 përqind nga 19.2 përqind një vit më parë. Ndërsa, kthimi në asete mbeti në nivelin e njëjtë prej 2.5 përqind (grafiku 34).

**Raporti i kredive joperformuese zbriti në 1.8 përqind, me rënie të lehtë prej 0.2 pikë përqindje në baza vjetore dhe 0.1 pikë përqindje në baza tremujore.”** Ky zhvillim ishte rezultat i rritjes relative më të ulët të vlerës së kredive jo-performuese në raport me rritjen e përshpejtuar të gjithsej kredive gjatë TM1 2025 (grafiku 35). Në anën tjetër, mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë shënoi rënie në 125.8 përqind nga 141.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, si rezultat i rënies së vlerës së provizioneve të ndara për mbulimin e kredive dhe rritjes në vlerë të ekspozimeve jo-performuese nga viti i kaluar. Megjithatë, krahasuar me fundin e tremujorit paraprak, ky tregues ka shënuar rritje të lehtë prej 1.4 pikë përqindje.


**Norma e kredive jo-performuese shënoi rënie vjetore si për segmentin e korporatave jofinanciare, ashtu edhe atë të ekonomive familjare.** Më konkretisht, raporti i kredive jo-performuese për korporatat jo-financiare zbriti në 2.1 përqind, ndërsa për ekonomitë familjare zbriti në 1.4 përqind. Ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje të ngadalësuar të ekspozimeve jo-performuese, apo rritje prej 19.1 përqind nga 33.2 përqind një vit më parë. Krahasuar me tremujorin paraprak, raporti i kredive jo-performuese për ekonomitë familjare mbeti thuajse i pandryshuar, me rënie marginale prej vetëm 0.04 pikë përqindje. Po ashtu, korporatat jofinanciare ngadalësuan ritmin e rritjes vjetore të ekspozimeve jo-performuese në 4.9 përqind nga 10.6 përqind një vit më parë. Në kuadër të

**Grafik 34. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar**



Burimi: BQK.

**Grafik 35. Ndryshimi vjetor i vlerës së KJP-ve dhe Raporti i KJP-ve ndaj gjithsej kredive**




Burimi: BQK.


KJF-ve, sektori i shërbimeve dhe tregtisë kishin rënie të lehtë vjetore të raportit të KJP-ve ndaj kredive për më pak se 1 pikë përqindje, duke rezultuar në normë të KJP-ve prej 2.8 përqind për sektorin e shërbimeve dhe 1.3 përqind për tregtinë. Po ashtu, sektori i ndërtimitarisë shënoi rënie vjetore marginale prej 0.1 pikë përqindje të raportit të KJP-ve ndaj gjithsej kredive, duke zbritur në 2.8 përqind si pasojë e rritjes më të lartë të gjithsej kredive në krahasim me rritjen e kredive jo-performuese. Në anën tjetër, sektorët që shënuan rritje vjetore të normës së KJP-ve ishin prodhimtaria dhe komunikacioni. Norma e KJP-ve arriti në 2.8 përqind nga 2.3 përqind për sektorin e prodhimtarisë dhe 2.9 përqind nga 1.1 përqind për atë të komunikacionit.

**Pozicioni i kapitalit, i shprehur përmes normës së kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara me rrezik, arriti në 16.2 përqind nga 16.1 përqind në vitin paraprak.** Megjithatë, krahasuar me fundin e vitit 2024, ky tregues ka shënuar rënie për 1.2 pikë përqindje. Rritja e lehtë vjetore e normës së kapitalizimit u ndikua nga një rritje më e lartë kapitalit në raport me rritjen e mjeteve të peshuara me rrezik. Konkretisht, kapitali rregullativ i sektorit në TM1 2025 shënoi rritje vjetore prej 15.4 përqind nga 14.6 përqind një vit më parë. Kurse, mjetet e peshuara me rrezik shënuan rritje prej 15.0 përqind nga 13.4 përqind në mars 2024 (grafiku 36). Në anën tjetër, rënia e normës së kapitalizimit krahasuar me tremujorin paraprak pasqyron një ulje prej 4.3 përqind të kapitalit rregullativ – kryesisht si rezultat i dividendës së paguar gjatë kësaj periudhe, në kushtet kur mjetet e peshuara me rrezik u rritën me 2.8 përqind.

Grafik 36. Treguesi i solvencës



Grafik 37. Treguesit e likuiditetit



**Treguesit e likuiditetit dhe financimit shënuan rënie krahasuar me vitin e kaluar, përkundër që janë dukshëm mbi nivelin e kërkuar rregullator.** Treguesi i mbulimit me likuiditet (LCR) zbriti në 185.4 përqind në mars 2025, duke shënuar rënie për 30.2 pikë përqindje, megjithatë qëndroi lartë mbi minimumin prej 100 përqind të kërkuar me rregullore. Ky nivel indikon se bankat mbajnë mjaftueshëm mjete likuide për të plotësuar nevojat dalëse (rrjedhjes së parasë) përgjatë 30 ditëve kalendarike të periudhës stresuese. Po ashtu, edhe treguesi i Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR) shënoi rënie në 134.8 përqind nga 142.7 përqind në mars 2024, por mbetet mbi minimumin rregullativ prej 100 përqind duke sugjeruar se bankat disponojnë


financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për të mbuluar kërkesat më afatgjata të financimit/likuiditetit. Tutje, raporti i likuiditetit - i shprehur si raport i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra - shënoi rënie vjetore për 1.6 pikë përqindje, duke zbritur në 29.8 përqind. Kjo si rezultat i rritjes vjetore më të theksuar të detyrimeve afatshkurtra me 17.2 përqind në raport me rritjen prej 11.3 përqind të mjeteve likuide. Gjithashtu, rritja më e shpejtë e kreditimit në raport me depozitat ka ndikuar në rritjen e raportit kredi-depozitë për 3.7 pikë përqindje, duke arritur në 87.8 përqind (grafiku 37).

#### 4.2. Sektori pensional


**Sektori pensional u karakterizua nga rreziqe të shtuara në tregjet financiare, të cilat u reflektuan në kthim negativ nga investimet, në kontrast me performancën pozitive të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar Megjithatë, vlera e asetëve vijoi rritjen dyshifrore vjetore, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak.** Në fund të tremujorit të parë të vitit 2025, asetet e sektorit pensional arritën në 3.2 miliardë euro, duke reflektuar ngadalësim të rritjes vjetore për 4.4 pikë përqindje (Grafiku 38). Dinamika e sektorit u përcaktua kryesisht nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), i cili përfaqësonte 99.7 përqind të gjithë asetëve në fund të marsit 2025. Rritja vjetore e asetëve të këtij fondi u ngadalësua në 12 përqind, nga 16.4 përqind një vit më parë. Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP) shënoi ngadalësim edhe më të theksuar, me rritje vjetore prej 4.1 përqind krahasuar me 12.6 përqind.

**Struktura e portofolit investiv të sektorit pensional gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 ka reflektuar reagim të menjëhershëm ndaj zhvillimeve të pafavorshme në tregjet ndërkombëtare, duke rezultuar në zhvendosje të pjesshme të investimeve drejt tregut të brendshëm.** FKPK shënoi ngadalësim të ritmit vjetor të rritjes së investimeve në tregun e jashtëm, në 9.6 nga 29.7 përqind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Si rrjedhojë, pjesëmarrja e këtyre investimeve në totalin e portofolit zbriti nga 79.0 përqind në 77.4 përqind. Këto investime mbeten të përqëndruara pothuajse tërësisht në fondet e përbashkëta, me 99.9 përqind pjesëmarrje. Në të njëjtën kohë, investimet në tregun e brendshëm shënuan rritje të konsiderueshme prej 20.9 përqind, duke kompensuar rënie prej 16.0 përqind të shënuar në tremujorin e parë të vitit paraprak. Në kuadër të investimeve në tregun e brendshëm, dinamikat u karakterizuan nga një zhvendosje drejt instrumenteve më fleksibile dhe likuide. Certifikatat e depozitave shënuan rritjen më të lartë si në terma nominale, ashtu edhe për nga pesha në portofol, duke u zgjeruar me 69.0 përqind dhe duke rritur pjesëmarrjen e tyre nga 15.1 përqind në 21.1 përqind. Në të kundërtën, letrat me vlerë – që mbetet zëri më dominues i investimeve në tregun e brendshëm – shënoi rritje modeste prej 4.8 përqind, duke zbritur pjesëmarrjen nga 82.8 përqind në 71.7 përqind. Totali i mjeteve likuide

Grafiku 38. Asetet e sektorit pensional




Grafiku 39. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



të mbajtura jashtë tregjeve investive (paraja e gatshme dhe paraja në BQK) u trefishuan, duke u rritur në mbi 51.9 milionë euro. Si rezultat, pesha e tyre në totalin e investimeve u rrit nga 2.1 përqind në 7.2 përqind, duke reflektuar orientim më të kujdesshëm në menaxhimin e likuiditetit dhe ruajtje më të madhe të mjeteve në formë të gatshme përballë pasigurive në tregjet financiare.

FSKP ndoqi strategji të ngjashme investimi, duke rritur ekspozimin në të dy tregjet por me ritëm më të shpejtë në tregun e brendshëm. Investimet në tregun e jashtëm, shënuan rritje vjetore prej 3.0 përqind, ndërsa ato në tregun e brendshëm shënuan rritje prej 67.7 përqind duke rritur pjesëmarrjen në gjithsej investimet në 22.5 përqind nga 15.1 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Brenda portofolit të përgjithshëm, 94.1 përqind e mjeteve janë investuar në aksione, 5.7 përqind në letra me vlerë, ndërsa 0.3 përqind mbahet në para të gatshme. Në kuadër të investimeve në tregun e brendshëm, letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës përbëjnë 75.7 përqind të totalit të aseteve të FSKP-së. Pjesa tjetër e këtij portofoli përfshin para të gatshme me pjesëmarrje prej 7.5 përqind dhe depozita në banka komerciale që përfaqësojnë 16.9 përqind.


Grafik 40. Performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK.

**Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, fondet pensionale realizuan kthim negativ nga investimet në vlerë prej 40.5 milionë euro, krahasuar me kthimin pozitiv prej 108.8 milionë euro të shënuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky zhvillim u ndikua nga tensionet tregtare të shkaktuara nga rritja e tarifave në tregtinë ndërkombëtare, të cilat kanë gjeneruar pasiguri dhe luhatshmëri të shtuar në tregjet globale të aksioneve ku sektori pensional i Kosovës është i ekspozuar. FKPK shënoi kthim bruto negativ prej 40.3 milionë euro, krahasuar me kthimin pozitiv prej 108.3 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit paraprak, si pasojë e rënies së ndjeshme në tregjet financiare ndërkombëtare (grafiku 40). Kjo rënie ndikoi kryesisht portofolin standard, i cili përfshin kontribuuesit deri në moshën 57 vjeç dhe ka ekspozim më të lartë ndaj instrumenteve me rrezik. Ndërkohë, kontribuuesit mbi 63 vjeç – të cilët janë në fazën e tërheqjes së kontributeve – përfitojnë nga një strukturë më konservatore investimesh dhe shënuan kthim pozitiv, duke qenë të mbrojtur nga luhatjet e tregjeve. Humbjet e shënuara përfaqësojnë zhvlerësim të porealizuar të portofolit të cilat rikuperohen me përmirësimin e kushteve të tregut. Pavarësisht performancës së përgjithshme negative të investimeve, çmimi i njësisë së aksioneve të FKPK-së u rrit lehtësisht në 1.79 euro nga 1.74 euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.**

Grafik 41. Performanca e FSKP-së



Burimi: FSKP.

Portofoli i FSKP-së u ndikua gjithashtu nga luhatjet në tregjet financiare ndërkombëtare, duke rezultuar një kthim bruto negativ prej 240 mijë euro gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, krahasuar me kthimin pozitiv prej 520 mijë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë (grafiku 41). Ngjashëm me zhvillimet në FKPK, kjo rënie pasqyron zhvlerësimin e përkohshëm të aseteve të investuara, i ndikuar nga

ambienti financiar ndërkombëtar, por nuk përbën humbje të realizuar, për sa kohë çmimi i aseteve mund të rikuperohet në periudhat e ardhshme. Çmimi i aksioneve të FSKP-së shënoi rritje në 2.09 euro për njësi, nga 2.07 euro një vit më parë.


**Arkëtimet nga kontributet shënuan rritje të lehtë, duke arritur në 86.4 milionë euro për dy fondet nga 76.0 milionë euro të shënuar në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Kjo rritje e lehtë në arkëtimet përmes kontributeve ka ndihmuar në ruajtjen e trendit pozitiv të rritjes së përgjithshme të aseteve, pavarësisht performancës më të dobët të tregjeve financiare.** Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FKPK-ja deri në fund të tremujorit të parë arriti në 86.1 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 13.5 përqind, nga 14.6 përqind një vit më parë (grafiku 40). Përkundër rritjes së vlerës së arkëtimeve, kishte rënie vjetore prej 1.1 përqind të numrit të llogarive aktive në TM1 2025, në kontrast me rritjen prej 3.7 përqind të shënuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërkohë, kontributet e mbledhura nga FSKP-ja në fund të tremujorit të parë 2025 shënuan rritje në 260 mijë euro nga 160 mijë euro në periudhën e njëjtë të një viti më parë.

### 4.3. Sektori i sigurimeve

**Sektori i sigurimeve shënoi ritëm më të ngadalësuar të rritjes vjetore të aseteve, duke reflektuar ngadalësimin e rritjes së primeve të shkruara, me ndikimin më të madh nga segmenti më i madh i tregut – sigurimet jo-jetë.** Asetet shënuan rritje vjetore prej 8.0 përqind duke arritur në 341.4 milionë euro (grafiku 42). Struktura e aseteve mbeti e orientuar kryesisht në instrumente me rrezik të ulët dhe likuiditet të lartë, ku dominuan depozitat bankare dhe letrat me vlerë. Depozitat bankare shënuan rritje vjetore prej 15.6 përqind duke rritur pjesëmarrjen në totalin e aseteve nga 44.2 përqind në 48.1 përqind. Ndërsa, letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, si kategoria e dytë më e rëndësishme në portofol, shënoi ngadalësim të ritmit të rritjes, nga 10.9 përqind në mars 2024 në vetëm 1.1 përqind në mars 2025. Si rezultat, pjesëmarrja e tyre në strukturën e aseteve zbriti lehtësisht, nga 16.5 përqind në 15.4 përqind. Po ashtu, rezervat teknike të risiguresve shënuan ngadalësim të rritjes vjetore, nga 8.1 përqind në vetëm 1.1 përqind, duke zbritur pjesëmarrjen e tyre në totalin e aseteve në 14.1 përqind nga 15.1 përqind një vit më parë.

**Vlera e përgjithshme e primeve të shkruara shënoi ngadalësim të ritmit të rritjes vjetore në 2.2 përqind, nga 21.7 përqind në të njëjtën periudhë të vitit paraprak (grafiku 43).** Në këtë ngadalësim kontribuan veçanërisht sigurimet “jo-jetë”, të cilat përbëjnë segmentin më të madh të tregut dhe shënuan rritje vjetore prej vetëm 2.0 përqind, në krahasim me 22.4 përqind një vit më parë. Brenda segmentit të sigurimeve “jo-jetë”, kategoria “Përgjegjësia motorike ndaj palës së tretë” (MTPL e brendshme) mbetet dominuese, duke përfaqësuar 49.8 përqind të totalit të primeve në mars 2025, nga 49.3 përqind një vit më parë. Kjo kategori


Grafiku 42. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

Qeverisë së Kosovës, si kategoria e dytë më e rëndësishme në portofol, shënoi ngadalësim të ritmit të rritjes, nga 10.9 përqind në mars 2024 në vetëm 1.1 përqind në mars 2025. Si rezultat, pjesëmarrja e tyre në strukturën e aseteve zbriti lehtësisht, nga 16.5 përqind në 15.4 përqind. Po ashtu, rezervat teknike të risiguresve shënuan ngadalësim të rritjes vjetore, nga 8.1 përqind në vetëm 1.1 përqind, duke zbritur pjesëmarrjen e tyre në totalin e aseteve në 14.1 përqind nga 15.1 përqind një vit më parë.

Grafiku 43. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.

shënoi rritje vjetore të primeve prej 6.3 përqind nga 10.1 përqind rritje të shënuar në të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Nga ana tjetër, kategoria “*Sigurimi i sëmundjeve*”, si e dyta për nga pesha në këtë segment me 25.3 përqind të totalit të primeve, shënoi rënie vjetore prej 1.9 përqind kundrejt rritjes së theksuar prej 31.8 përqind në mars 2024.

Spektori i sigurimeve “jo-jetë” shënoi po ashtu rënie të theksuar vjetore të numrit të policave, prej 20.2 përqind për dallim nga rritja e konsiderueshme prej 51.0 përqind në TM1 2024. Numri i policave të kategorisë së sigurimit të shëndetit kontribuoi më së shumti në këtë rënie, si rezultat i tkurrjes me 42.5 përqind pas rritjes së konsiderueshme prej 123.3 përqind një vit më parë. Si pasojë, pjesëmarrja e kësaj kategorie në totalin e policave të sigurimit “jo-jetë” zbriti në 34.8 përqind nga 48.3 përqind në mars 2024. Ndërkohë, kategoria “*Përgjegjësia motorike ndaj palëve të treta*” (MTPL), që përfaqëson 57.5 përqind të numrit të përgjithshëm të policave, regjistroi rritje modeste prej 1.7 përqind krahasuar me rritjen prej 16.7 përqind në TM1 2024.

Sigurimet “jetë”, të cilat përbëjnë një pjesëmarrje relativisht të ulët në gjithsej primet (4.5 përqind), shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind nga 9.6 përqind një vit më parë. Vlera e primeve të shkruara bruto në segmentin e sigurimeve të “jetës” është ndikuar kryesisht nga kategoria “*Jeta e Debitorit*”, e cila përfaqësonte 51.8 përqind të totalit të primeve në këtë segment në mars 2025. Kjo kategori shënoi rritje vjetore prej 10.6 përqind, nga rritja prej 20.0 përqind të shënuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërkohë, kategoria “*Jeta e kombinuar*”, e cila zë 34.0 përqind të totalit të primeve në këtë segment, u karakterizua me rënie vjetore prej 1.72 përqind nga rënia prej 0.18 përqind në mars 2024.

**Dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve shënuan rritje vjetore prej 22.1 përqind në mars 2025, pas rënies prej 10.8 përqind në periudhën e njëjtë të një viti më parë (grafiku 43).** Dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve shënuan rritje vjetore prej 27.5 përqind nga një rënie prej 13.3 përqind, ndërsa dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimeve shënuan një rënie vjetore prej 23.4 përqind, në kontrast me rritjen prej 17.6 përqind të shënuar në periudhën paraprake. Ndërkohë, dëmet e mbuluara nga risiguruesit u rritën ndjeshëm, pothuajse duke u trefishuar krahasuar me një vit më parë. Në kuadër të dëmeve të paguara në sigurimin e jo-jetës, kategoria “*Përgjegjësia motorike ndaj palëve të treta*”, me pjesëmarrje 50.4 përqind, shënoi rritje vjetore prej 4.3 përqind dhe arriti në 10.6 milionë euro. Kjo rritje u ndikua kryesisht nga dëmet e lidhura me policat kufitare dhe MTPL-të e brendshme. Ndërkohë, kategoria “*Sigurimi i sëmundjeve*”, që përbënte 25.2 përqind të totalit, shënoi rritje vjetore prej 7.6 përqind, duke arritur në 5.3 milionë euro.

**Fitimi neto i sektorit shënoi rritje vjetore prej 6.7 përqind, duke arritur në 4.0 milionë euro, si rezultat i rritjes më të shpejtë të të hyrave krahasuar me ritmin më të ngadalësuar të zgjerimit të shpenzimeve.** Të hyrat totale, të mbështetura kryesisht nga primet e shkruara, u rritën me 4.3 përqind dhe arritën në 36.6 milionë euro, ndërsa shpenzimet u zgjeruan me ritëm më të ngadalësuar prej 4.0 përqind, duke arritur vlerën prej 32.7 milionë euro. Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të pranuar u rrit në 50.8 përqind në mars 2025, nga 42.5 përqind një vit më parë, si pasojë e rritjes më të shpejtë të dëmeve krahasuar me të hyrat nga primet (grafiku 43). Brenda strukturës së shpenzimeve, dëmet e paguara shënuan rritje prej 3.7 përqind, duke arritur në 19.5 milionë euro, ndërkohë që shpenzimet operacionale – përfshirë ato për personelin dhe administratën – u rritën me 3.5 përqind, duke arritur në 12.3 milionë euro. Treguesit e profitabilitetit kanë shënuar rënie për shkak të zgjerimit më të shpejtë të bazës së aseteve dhe kapitalit. Si pasojë, kthimi mesatar në asete (ROA) zbriti në 5.4 përqind nga 6.0 përqind, ndërsa kthimi mesatar në kapital (ROE) zbriti nga 21.1 përqind në 17.7 përqind në mars 2025.

**Treguesit e qëndrueshmërisë së sektorit të sigurimeve të segmentit dominues jo-jetë shënuan përmirësim në nivel të sektorit, përderisa sigurimet e jetës u karakterizuan me zhvillime të ndyshueshme në këta tregues, por të cilët ishin mbi kërkesat rregullatore.** Kapitali në raport me marginën e solvencës për siguresit jo-jetë u rrit në 170.0 përqind nga 150.2 përqind në të njëjtën periudhë të

vitit të kaluar, ndërsa për siguruesit jetë ky raport shënoi rënie të lehtë vjetore, duke arritur në 680.9 përqind nga 716.0 përqind. Kapitali në raport me fondin garantues për siguruesit jo-jetë qëndron mbi kufirin minimal të kërkuar dhe u rrit tutje në 195.4 përqind nga 158.3 përqind në vitin 2024. Edhe për siguruesit jetë, ky tregues u përmirësua, duke arritur në 177.0 përqind nga 143.6 përqind një vit më parë. Treguesi i mbulueshmërisë me provizione teknike të sektorit të sigurimeve jo-jetë regjistroi përmirësim të lehtë në 113.0 përqind, nga 109.2 përqind në mars 2024. Ndërkohë, sektori i sigurimeve jetë pësoi një ulje të lehtë, me mbulueshmërinë që zbriti në 117.9 përqind nga 115.5 përqind në periudhën përkatëse të vitit të kaluar. Treguesit e likuiditetit gjithashtu shënuan përmirësim, me raportin ndërmjet mjeteve likuide dhe provizioneve teknike që u rrit në 95.7 përqind krahasuar me 91.1 përqind në fund të marsit 2024. Po ashtu, raporti ndërmjet mjeteve likuide dhe gjithsej detyrimeve u përmirësua në 83.5 përqind nga 79.5 përqind një vit më parë.

#### 4.4. Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar


**Sektori vazhdoi rritjen e lartë dyshifrore, me zgjerim vjetor të aseteve prej 18.5 përqind në mars 2025, ndonëse me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me rritjen e theksuar të vitit paraprak. Kjo dinamikë reflekton trendin e ngadalësuar të rritjes së burimeve të jashtme të financimit.** Vlera e aseteve të sektorit arriti në 671.4 milionë euro. Struktura e portofolit vijon të dominohet nga kreditë, pasuar nga lizingjet dhe mjetet likuide të mbajtura në bankat komerciale (grafiku 44). Me përjashtim të bilanceve në bankat komerciale, të cilat shënuan rënie vjetore, të gjitha kategoritë e tjera të aseteve u karakterizuan me rritje vjetore.

Nga ana e financimit, huamarrjet nga sektori i jashtëm – burimi kryesor i financimit për këtë sektor – vijuan rritjen, por me ritëm më të ngadalësuar, duke u rritur me 17.0 përqind në mars 2025 krahasuar me 34.3 përqind një vit më parë.

**Stoku i kredive të sektorit arriti në 471.1 milionë euro, duke vazhduar me trendin e lartë të rritjes prej 25.0 përqind nga 24.0 përqind një vit më parë.** Kreditimi për ekonomitë familjare u rrit në 276.9 milionë euro, me rritje vjetore prej 21.7 përqind nga 18.5 përqind në mars 2024, ndërsa kreditimi për korporatat jo-financiare u zgjerua në 194.2 milionë euro, me një rritje prej 30.0 përqind nga 33.5 përqind në mars 2024 (grafiku 45). Kjo dinamikë u reflektua edhe në strukturën e portofolit të kredive, ku pjesëmarrja e kredive për korporatat jo-financiare u rrit në 41.2 përqind nga 39.6 përqind një vit më parë, ndërsa pjesëmarrja e kredive për ekonomitë familjare zbriti në 58.8 përqind nga 60.4 përqind.


Të gjithë sektorët e ekonomisë shënuan rritje, me atë të tregtisë që shënoi rritjen më të lartë prej 32.4 përqind. Por, për shkak të peshës më të lartë në portfolion e kredive të korporatave jo-financiare të sektorit të bujqësisë,

Grafik 44. Asetet e sektorit mikrofinanciar dhe IFJB



Burimi: BQK.


Grafik 45. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare



Burimi: BQK.


i cili po ashtu shënoi rritje të lartë prej 26.4 përqind, ky sektor kishte kontributin më të lartë në rritje (grafik 46 dhe 47).

**Grafik 46. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë**



Burimi: BQK.


**Grafik 47. Kontributi në rritje të kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë**



Burimi: BQK.


**Lizingu ka shënuar rënie të pjesëmarrjes në asetet e sektorit mikrofinanciar dhe ngadalësim të ritmit të rritjes në 7.7 përqind krahasuar me rritjen e theksuar prej 30.2 përqind në vitin e kaluar. Ky ngadalësim është veçanërisht i shprehur në segmentin e korporatave jofinanciare i cili dominon strukturën me pjesëmarrje prej 74.5 përqind në mars 2025. Ndërsa lizingu për ekonomitë familjare shënoi rënie vjetore prej 7.9 përqind, në kontrast me rritjen prej 3.2 përqind të shënuar një vit më parë (Grafiku 48).**

**Grafik 48. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar**



Burimi: BQK.


**Grafik 49. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar**



Burimi: BQK.

**Norma mesatare e interesit në kredinë e lëshuar nga sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar mbeti pothuajse e pandryshuar në nivelin 18.9 përqind, me një ndryshim marginal prej -0.1 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Ky stabilitet mesatar reflekton lëvizje të kundërta ndërmjet dy segmenteve: për korporatat jofinanciare norma zbriti për 0.5 pikë përqindje, ndërsa për ekonomitë familjare u rrit për të njëjtën magnitudë (grafiku 49). Norma më të favorshme të interesit kishin korporatat jo financiare, prej 15.7 përqind. Në nivel të sektorëve ekonomik, kreditë për sektorin**

**Grafik 50. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik**




Burimi: BQK.

e shërbimeve u karakterizuan me normën më të favorshme prej 17.2 përqind, megjithëse kjo kategori shënoi rritje vjetore të normës së interesit prej 1.8 pikë përqindje. Rritje të normës së interesit u shënuan gjithashtu edhe në sektorin e bujqësisë dhe të industrisë, përkatësisht me 0.8 dhe 0.5 pikë përqindje (grafiku 50). Nga ana tjetër, ekonomitë familjare kishin norma më të larta të interesit në raport me KJF-të, përkatësisht normë mesatare prej 21.8 përqind, duke u rritur për 0.5 pikë përqindje. Në mars 2025, norma e interesit për kreditë konsumuese u rrit për 2.4 pikë përqindje në 23.6 dhe norma e interesit për kreditë hipotekare u rrit për 1.3 pikë përqindje në 18.6 përqind.

**Fitimi neto i sektorit arriti në 5.6 milionë, duke shënuar rritje vjetore prej 17.5 përqind.** Të hyrat e përgjithshme të sektorit vazhduan rritjen e lartë gjatë periudhës raportuese, prej 20.9 përqind, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak, duke pasqyruar stabilizimin e normave të interesit dhe ndër tjera edhe efektin e bazës më të lartë krahasuese. Rritja vazhdoi të mbështetet kryesisht nga të hyrat nga interesi, të cilat mbetën burimi dominues i të ardhurave, duke reflektuar zgjerimin e aktivitetit kreditues. Edhe të hyrat nga jo-interesi kontribuan në rritje, megjithëse me një ritëm shumë më modest sesa vitin e kaluar. Shpenzimet e përgjithshme gjithashtu ngadalësuan ritmin e rritjes vjetore në 21.9 përqind, duke reflektuar stabilizimin gradual të kostove pas rritjes së theksuar në vitet e fundit të ndikuar nga inflacioni dhe kosto e lartë e financimit. Kontributin kryesor në këtë ngadalësim e dhanë shpenzimet e jo-interesit, të cilat vijuan rritjen, por me intensitet më të ulët, veçanërisht në kategorinë e shpenzimeve për personel dhe ato administrative. Në anën tjetër, shpenzimet e interesit shënuan rritje të lartë prej 37.5 përqind, ndonëse paraqet ngadalësim të theksuar krahasuar me vitin paraprak, në përputhje me normalizimin e kushteve të financimit.


Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave u rrit në 77.5 përqind në mars 2025, nga 76.8 përqind një vit më parë, duke reflektuar rritjen lehtësisht më të shpejtë të shpenzimeve në raport me të hyrat. Rrjedhimisht, indikatorët

Grafik 51. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Grafik 52. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK.

Grafik 53. Niveli i kredive joperformuese për IMF-të dhe IFJB-të.



Burimi: BQK.

kryesorë të profitabilitetit shënuan rënie, me kthimin mesatar në asete që zbriti në 3.6 përqind nga 4.6 përqind dhe kthimin mesatar në kapital që zbriti nga 16.6 përqind në 13.3 përqind.


**Raporti i kredive joperformuese ndaj totalit të kredive në sektorin e institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jobankare mbeti i pandryshuar në 1.7 përqind në fund të marsit 2025, duke treguar një stabilitet në cilësinë e portofolit të kreditimit.** Mbulueshmëria e këtyre kredive me provizione vazhdoi të jetë e qëndrueshme, megjithëse zbriti lehtë në 148.3 përqind, nga 154.5 përqind në periudhën paraprake (grafiku 52). Nga ana tjetër, raporti i kredive jo-performuese mbetet më i lartë për institucionet financiare jobankare (IFJB) krahasuar me institucionet mikrofinanciare (IMF), përkundër rënies së raportit tek IFJB-të. Për IMF-të, ky raport qëndroi i njëjtë në 1.5 përqind, ndërsa për IFJB-të shënoi rënie në 2.4 përqind nga 2.8 përqind në periudhën paraprake (grafiku 53).

#### 4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës

Në tremujorin e parë të vitit 2025, Qeveria e Republikës së Kosovës emetoi borxh në vlerë prej 60.0 milionë euro, duke shënuar rritje prej 18.9 perqind (grafiku 54). Megjithatë, raporti i borxhit të brendshëm ndaj Bruto Produktit Vendor (BPV) zbriti lehtësisht në 8.43 përqind në mars 2025 nga 8.96 përqind në mars 2024, ndikuar kryesisht nga amortizimi i borxhit të brendshëm. Në fund të marsit 2025, stoku i borxhit të brendshëm në formë të letrave me vlerë zbriti në 934.7 milionë euro, nga 945.0 milionë euro në të njëjten periudhë të vitit të kaluar.


Pavarësisht normës më të ulët të kthimit, kërkesa për letrat me vlerë mbeti e lartë dhe tejkaloi ofertën. Megjithatë, qeveria emetoi vetëm 60.0 milionë euro, që është 49.9 milionë euro më pak se kërkesa totale (grafiku 55).

Grafik 54. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor




Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 55. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 56. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturitet, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Mbajtësit e letrave me vlerë qeveritare vazhdojnë të udhëhiqen nga fondet pensionale që përbëjnë 46 përqind të stokut të borxhit qeveritar, pasuar nga bankat komerciale me 21 përqind, institucionet publike me 24 përqind dhe kompanitë e sigurimit që përbëjnë 5 përqind të stokut të borxhit. Gjatë këtij tremujori, letrat me vlerë të emetuara përbëheshin nga obligacione me maturim dy, tre dhe pesë vite, secila duke përbërë 33.3 përqind të shumës totale të emetuar prej 60.0 milionë euro (grafiku 56).

## Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 50, TM1 2025, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

### Referencat:

#### **BQK:**

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](#)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](#)
- c) Regjistri i Kredive: [Regjistri i Kredive - BQK \(bqk-kos.org\)](#)

#### **ASK:**

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostos së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat ë tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

#### **Të tjera:**

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](#)
- d) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Të dhënat nëntëmujore mbi borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/5dd2850a-be21-4e50-8860-9df088b1c540.pdf>
- e) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Raport Nëntëmujor Financiar, Buxheti i Republikës së Kosovës: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/6d90a295-b45d-42c7-9982-242354d26b5a.pdf>

**Euribor:** Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

**ECB (BQE):** Economic Bulletin [Research & Publications \(europa.eu\)](#); [Key ECB interest rates \(europa.eu\)](#)

**FAO:** [Home | Food and Agriculture Organization of the United Nations \(fao.org\)](#)

**IMF (FMN):** [International Monetary Fund \(IMF\)](#)

**World Economic Outlook:** [World Economic Outlook \(imf.org\)](#)

**World Bank:** Commodity Markets: [Commodity Markets \(www.worldbank.org\)](#)



Rr. Garibaldi, nr. 33, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)